



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kmshc.al



www.kmshc.al

23 Dhjetor 2024

NJOFTIM

MBI TAKIMIN E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL DHE KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË PRISHTINË

Në dhjetor 2024, me ftesë të Këshillit të Pavarur Mbrojtës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përfaqësues të lartë të Komisionerit për Mbrojtjen e Shërbimit Civil morën pjesë në një takim disa ditor me përfaqësues të këtij institucioni. Takimi kishte si qëllim diskutimin e çështjeve të ndryshme të shërbimit civil dhe trajtimin e problematikave të hasura gjatë periudhës së fundit, ku një vend të rëndësishëm zunë diskutimet mbi procedurat ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbrojtës, trajtimi i ankesave të nëpunësve civilë, problematikat e hasura gjatë hartimit të përshkrimeve të punës nga institucionet dhe asistenca e ofruar nga KPMSHC, si dhe mënyra e trajtimit nga organet gjyqësore të vendimeve të këtij institucioni.

Ky takim shërbeu si një mundësi e rëndësishme për ndarjen e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve.

